



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:228495

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05637034

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit “BP CONSULTING” L.L.C., me adresë në Prishtinë rruga “Ilaz Kodra”, BL.Nr.5/7, H.4, me NUI:810099160, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Florian Petani avokat me seli të zyrës në Prishtinë, kundër debitorit “Hidroterm” Sh.P.K., me seli në Suharekë, rruga “Brigada 123” pn, 23000, me NUI: 810634867, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Nadire Hoxha avokate me seli të zyrës në Suharekë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.213/2023 të datës 29.09.2023, të nxjerrë nga Përbaruesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 17.04.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “Hidroterm” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.213/2023 të datës 29.09.2023, të nxjerrë nga Përbaruesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi, dhe i njejtë Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.
- II. Detyrohet debitori që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj kreditorit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë sipas prapësimit të debitorit në shumë të përgjithshme prej 208 €, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim nga avokati.

## A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.213/2023 të datës 29.09.2023, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përmbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturës nr.2020/033 të datës 04.11.2020, me të cilin ka urdhëruar debitorin që brenda afatit prej 7 ditëve nga dita e pranimi të këtij urdhri, në emër të pagesës së borxhit kryesor, të kalojë shumën prej 12,000.00 Euro në xhirollogarinë e veçantë të kreditorit, me kamatëvonesë prej 8 % sipas LMD-së, si dhe shpenzimet e përmbarimit dhe të përfaqësimit, nën kërcënim të pasojave ligjore.

Kundër urdhrin të Përmbaresit Privat, debitori ka ushtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor në tërësi si të pabazuar, me arsyetimin se urdhri nuk i plotëson kushtet formale, ngase fatura e dorëzuar nuk është në origjinal apo kopje të vërtetuar, duke theksuar se Përmbaresi Privat nuk është dashur që të vazhdojë më tutje me propozimin për përmbarim, pa eliminimin e të metave në fjalë. I ka propozuar gjykatës që të aprovet në tërësi prapësimi, ndërsa të anulohet urdhri përmbarimor i lëshuar nga Përmbaresi Privat, si dhe të detyrohet kreditori t'ia kompensojë shpenzimet procedurale debitorit për prapësimin e paraqitur në shumën prej 650 Euro.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ka theksuar se shkaqet mbi të cilat mbështetet prapësimi janë tërësisht të pabazuara dhe të paqëndrueshme, për shkak se propozimit dhe urdhrin për përmbarim i është bashkangjitur origjinali i faturës nr.2020/033 i datës 04.11.2020 dhe jo fotokopje e thjeshtë, siç gabimisht pretendon përfaqësuesja e debitorit. Më tej ka shtuar se dokumenti përmbares mbi të cilin mbështetet urdhri për përmbarim përbën dokument të besueshëm, siç përcaktohet me nenin 29.1 nënpar. 1.3 të LPP-së dhe si i tillë është i përshtatshëm për përmbarim, konform nenit 29.3 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit ndërsa të mbetet në fuqi urdhri i Përmbaresit Privat, si dhe të detyrohet debitori që t'ia kompensojë kreditorit shumën totale prej 416 Euro në emër të shpenzimeve të procedurës, dhe atë për përpilimin e propozimit për përmbarim shumën prej 208 Euro, si dhe përpilimin e përgjigjes në prapësim shumën prej 208 Euro.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentin e besueshëm faturën nr.2020/033 të datës 04.11.2020, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nr.2020/033 të datës 04.11.2020, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, e njejta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin dhe vulën e debitorit.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par. 1 dhe 463 par.1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së. Gjykata e gjeti si të bazuar kërkesën e kreditorit për pagesë të shpenzimeve sa i përket përpilimit të përgjigjes në prapësim, ndërsa lartësinë e saj gjykata e llogariti duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve të nxjerrë nga Oda e Avokatëve më 18 mars 2017, siç përcakton neni 453 para. 2 LPK-së lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, ashtu që si bazë u mor lartësia e vlerës së përmbarimit, numri i palëve të përfaqësuara, si dhe lloji i veprimit procedural për të cilin janë kërkuar shpenzimet.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1711/23, me datë 17.04.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.